

Angazhimi Serb në Institucionet Qendrore të Kosovës

Hyrje

Pjesëmarrja e serbëve në institucionet e Kosovës ka kaluar nëpër një proces të vështirë. Pas luftës në Kosovë në vitin 1999, serbët e Kosovës formuan një koalicion të gjërë politik, Povratak, i cili mori pjesë në zgjedhjet e para të pasluftës në vitin 2000, dhe fitoi 22 ulëse, duke u bërë kështu forca e tretë më e madhe politike në parlamentin e Kosovës. Por përplasjet ndëretnike të vitit 2004 kishin bërë që serbët të tërhiqeshin nga parlamenti dhe të bojkotonin zgjedhjet parlamentare të vitit 2004 dhe 2007. Megjithatë, serbët kishin qëndruar në institucionet komunale të Kosovës, në gjyqësor, polici dhe administratë publike.

E gjithë kjo ndryshoi pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në shkurt të vitit 2008. Serbët e Kosovës u larguan nga të gjitha institucionet e Kosovës, dhe në maj të vitit 2008, qeveria e Serbisë kishte organizuar zgjedhjet e saja lokale në Kosovë dhe kishte krijuar institucionet “paralele” në komunat e banuara me shumicë serbe. Duke qenë se kishin marr një numër thelbësor votash, legjitimiteti i institucioneve paralele ka qenë i pakontestuar deri në nëntor të vitit 2009, kur serbët në jug votuan në një numër relativisht të madh në zgjedhjet lokale të Kosovës dhe zgjodhën zyrtarë të rinjë komunal. Megjithatë, në veri, dalja për të votuar ishte shumë e vogël.

Perceptimi se pjesëmarrja e serbëve në institucionet e Kosovës është e barabartë me njohjen e pavarësisë së Kosovës kishte bërë që komuniteti serb të përmbahet nga votimi në zgjedhjet e Kosovës dhe që qeveria e Serbisë të mos e mbështesë atë pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës në vitin 2008. E gjithë kjo ndryshoi pas marrëveshjes mes Prishtinës dhe Beogradit të arritur në Bruksel, më 19 prill të vitit 2013. Në pajtim me marrëveshjen dhe të inkurajuar nga Beogradi, serbët në veri të Kosovës votuan në masë më të madhe në zgjedhjet parlamentare të Kosovës të organizuara në qershor të vitit 2014, për herë të parë qysh nga shpallja e pavarësisë së Kosovës. Lista Srpska, e mbështetur nga Beogradi, fitoi 9 nga 10 ulëset parlamentare të rezervuara për serbët. Serbët kanë të drejtë për të mbajtur dy pozita ministrore në qeveri. Shumica presin një marrëdhënie të ndërlikuar mes partive shqiptare dhe Listës Srpska në koalicionin qeveritar, duke marrë parasysh së Srpska nuk e njeh pavarësinë e Kosovës, dhe së këndejmi, as institucionet e saj. Shumica pyesin se çfarë roli do ta marrë Srpska: rol pragmatik apo refuzues.

Për të adresuar rolin e serbëve në institucionet e Kosovës, Këshilli për Qeverisje Inkluzive ka organizuar më 17 shtator në Prishtinë një tryezë të rrumbullakët, për disa përfaqësues politik dhe të shoqërisë civile të Kosovës. Pjesëmarrësit kanë përfshirë përfaqësues të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lëvizjes Vetëvendosje (VV), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), kryetarë komunash dhe përfaqësues të komunave me shumicë serbe, si dhe një numër analistësh. Ttryeza e rrumbullakët është organizuar si pjesë e një projekti dyvjeçar mbi veriun e Kosovës dhe marrëdhëniet mes Kosovës dhe Serbisë, të financuar nga Departamenti Federal i Punëve të

Jashtme i Zvicrës.

Pjesëmarrësit në këtë tryezë të rrumbullakët kanë sygjëruar që përfaqësuesit e rinjë serbë do të duhej të ishin më pragmatik dhe të fokusohen në çështjet të cilat i brengosin serbët lokal, e jo në interesat nacionale të Serbisë. Folësit kanë listuar një numër çështjesh të cilat kanë përfshirë edukimin, posaçërisht legalizimin e Universitetit të Mitrovicës; shëndetësinë, me theks të veçantë në kornizën ligjore për klinikat serbe në Kosovë; privatizimin e kompanive në hapësirat me shumicë serbe me qëllim të ofrimit të benefiteve që dalin nga ky proces për popullsinë lokale; dhe bujqësinë me qëllim të rritjes së kapaciteteve të prodhimit dhe garantimit të qasjes së serbëve në tregjet lokale të Kosovës.

Ky raport, në pjesën më të madhe është i bazuar në diskutimet e tryezës së rrumbullakët, por poashtu përfshin përmbajtje nga takime individuale me pjesëmarrësit. Me qëllim të inkurajimit të diskutimit të hapur, komentet nuk u janë atribuar folësve specifik. Pjesëmarrësit kanë marrë pjesë në këtë diskutim në kapacitetet e tyre personale dhe pozicionet e tyre jodomosdoshmërisht pasqyrojnë ato të organizatave të cilat i përfaqësojnë.

Bashkëpunim apo refuzim

Një numër i folësve kanë thënë se bashkëpunimi i serbëve me komunitetin shumicë është kyç për një performancë të suksesshme në institucione dhe për përmirësimin e jetës së serbëve të Kosovës. Një pjesëmarrës me përvojë të gjatë në institucionet e Kosovës ka thënë se bashkëpunimi me partitë shqiptare duhet të fuqizohet, dhe se komuniteti ndërkombëtar duhet të vazhdojë ta lehtësojë atë. Shumë pjesëmarrës serbë kanë qenë të brengosur rreth përvojës së pamjaftueshme parlamentare të përfaqësuesve serbë. Sipas disa pjesëmarrësve serbë, për ndryshim nga Koalicioni Povratak, grupi i ri nuk ka kapacitete të mjaftueshme për të definuar dhe implementuar objektivat të cilat avancojnë interesat e serbëve në Kosovë. Për më shumë, ata poashtu kanë mungesë të legjitimitetit pasi që “ata kanë qenë të zgjedhur nga individët të cilët kanë mbushur kutitë e votimit në Beograd”, kanë thënë disa folës. Si pasojë e kësaj, shumë prej tyre kanë pritur që Beogradi të vazhdojë të negociojë me institucionet e Kosovës në emër të serbëve të Kosovës. Disa folës kanë thënë se kjo nuk është domosdoshmërisht një gjë e keqe, duke pasur parasysh mungesën e kapacitetit politik të komunitetit serb në Kosovë, por ata kanë qenë të brengosur se disa individë në Beograd mund t’i shtyejnë interesat e tyre individuale, në dëm të komunitetit serb.

Institucionet e Kosovës duhet të fillojnë një dialog të vërtetë me serbët e Kosovës në çështje rreth zhvillimit ekonomik, bujqësisë, edukimit dhe punësimit, ka rekomanduar një folës nga një parti opozitare. Ai ka thënë se partitë opozitare shqiptare janë të vendosura të fillojnë një dialog thelbësor me serbët, por “serbët ende nuk janë të gatshëm ta bëjnë këtë në mënyrë vetanake, duke preferuar që Beogradi të negociojë në emër të tyre”. Disa folës kanë thënë se ekziston rreziku që përfaqësuesit e rinjë të shihen si një dorë e zgjatur e Beogradit dhe rrjedhimisht, të mos merren seriozisht nga udhëheqësia shqiptare. Një numër folësish kanë fajësuar komunitetin ndërkombëtar për lejimin e vjedhjes së votave, gjë e cila ka bërë të mundshme zgjedhjen e një numri “kandidatësh të caktuar paraprakisht”. Disa kanë thënë se shumica e kandidatëve janë “nominuar, e nuk janë zgjedhur”. Por të tjerët e kanë justifikuar komunitetin ndërkombëtar “për mbylljen e syve, vetëm e vetëm që serbët të marrin pjesë në zgjedhjet e Kosovës”.

Një numër folësisht shqiptarë kanë thënë se legjitimiteti i përfaqësuesve serbë është një “çështje ndër-serbe”. Shqiptarët nuk do të duhej ta vënin në pikëpyetje legjitimitetin e përfaqësuesve serbë. “Kjo është ajo që kemi, dhe duhet të punojmë me atë që ekziston”. Fundi i fundit, një numër i madh i përfaqësuesve shqiptarë në zgjedhjet e fundit, kanë qenë rezultat i “vjedhjes industriale” të zgjedhjeve të vitit 2010. Ai ka shtuar se autenticiteti i udhëheqësisë është një mbivlerësim. Serbët kanë pasur përfaqësues autentik në të kaluarën, por megjithatë nuk kanë qenë në gjendje të bëjnë shumë. Ky folës ka theksuar se serbët në Kosovë kanë të drejtë të konsultohen me Beogradin, ashtu si edhe “shqiptarët kanë të drejtë të konsultohen me Tiranën apo Uashingtonin”. “Kur serbët ndihen se kanë mjaft pushtet dhe besojnë se Kosova është një vend i mirë, ata do të sillen ndryshe. Deri atëherë, Beogradi do të vazhdojë të luajë rol në këtë proces”. Një tjetër folës ka thënë se ai pajtohet që përfaqësuesit janë autentik, por “ata definitivisht nuk janë legjitim, duke marrë parasysh mënyrën se si janë zgjedhur”.

Dialogu i drejtpërdrejt mes Prishtinës dhe serbëve lokal mund të jetë më i vështirë se bisedimet e nivelit të lartë të lehtësuar nga BE-ja, sepse do të ishte origjinal, “jo një farsë sikurse procesi i Brukselit”, ka thënë një folës. Ai ka thënë se Beogradi nuk është i brengosur për serbët në Kosovë. Serbët kanë më shumë komuna, por nuk kanë jetë më të mirë. Dialogu i Brukselit i ka dhënë hapësirë mjaft të madhe Beogradit, por ka anashkaluar serbët e Kosovës, të cilët ende nuk kanë zgjidhje as edhe për shërbimet më bazike, sic janë kujdesi shëndetësor dhe edukimi. Kompetencat shtesë për komunat në veri nuk do ta përmirësojnë jetën e serbëve atje; ajo që u nevojitet atyre janë komuna profesionale dhe kompetente. Ai ka shtuar se dialogu me serbët duhet të fokusohet në politika programore, e jo në ato etnike. “Le të lëvizim nga politika etnike në politika joetnike”. Të gjithë qytetarët e Kosovës janë të pakënaqur me qeveritë e pasluftës, dhe kjo është pse serbët duhet të mbështeten jo vetëm në “përfaqësim, por edhe ta fuqizojnë pjesëmarrjen”, në mënyrë që dialogu të përfshijë më shumë njerëz, dhe jo vetëm të zgjedhurit. Shqiptarët dhe serbët e Kosovës nuk kanë nevojë të flasin për pajtimin, ata nuk i kanë bërë asgjë njëri tjetrit; pajtimi duhet të bëhet mes Kosovës e Serbisë, ka përfunduar ky folës.

Ky folës ka kritikuar si shqiptarët ashtu edhe serbët për fokusimin në individët në institucione, e jo në principet në të cilat politikat do të duhej të bazoheshin. Ai u ka bërë thirrje shqiptarëve dhe serbëve që t’i anashkalojnë politikanët e korruptuar të cilët vazhdojnë të përfitojnë në emër të patriotizmit. “Le të mos vazhdojmë t’i trajtojmë udhëheqësit tanë kriminel e të korruptuar si patriotë, le të mos i mbrojmë ata që janë të përfshirë në krim dhe korrupsion.”

Nuk ka nevojë të zbulohet asgjë në lidhje me rolin e serbëve në institucionet e Kosovës; ata përfaqësojnë interesat e komunitetit serb dhe besimi në ta do të ndërtohet gradualisht. Një folës ka thënë se komuniteti ndërkombëtar ka luajtur një rol pragmatik në zgjedhje, dhe se as serbët e as shqiptarët nuk do të duhej të prisnin që ata t’i zgjidhin të gjitha problemet e tyre. Folësi ka thënë se Beogradi poashtu ka lehtësuar procesin, dhe një lehtësim i tillë duhet të mirëpritet. “Pa përkrahjen e Beogradit, serbët nuk do të merrnin pjesë në zgjedhje dhe institucione”. Dialogu nuk ka bërë mrekullira, por ai ka mundësuar progresin dhe vendosjen e shume çështjeve në drejtimin e duhur. Ai ka thënë se serbët e Kosovës kanë të drejtë të konsultohen me Beogradin, dhe shqiptarët nuk duhet të brengosen për këtë. “Une do të konsultohesha me anëtarët e qeverisë së Shqipërisë, sikur ta njihja dikë që mund të më japë këshilla të mira”. Serbët e Kosovës kanë humbur shumë kohë, dhe duhet të fillojnë të punojnë sa më shpejtë që është e mundur. Ai ka

thënë se ata poashtu duhet të evitojnë veprime, siç ka qenë parku në urën e Mitrovicës, i cili do të mund të provokonte jo vetëm komunitetin tjetër, por edhe do të tërhiqte vëmendjen nga çështjet reale. Ai ka thënë se shqiptarët janë më të gatshëm se asnjëherë më parë që të bashkëpunojnë me serbët, dhe se serbët do të duhej të tregonin një nivel të njejtë të gatishmërisë, pasi që ata do të jenë përfituesit kryesorë. “60 milion euro janë në dispozicion të katër komunave në veri, por udhëheqësit e tyre janë duke refuzuar të ofrojnë bashkëpunimin e nevojshëm për të marrë fondet.”

Megjithatë, disa folës serbë kanë thënë se serbët janë duke e ngritur nivelin e bashkëpunimit me shqiptarët. Ata kanë marrë pjesë në zgjedhjet e Kosovës dhe tani janë duke marrë pjesë në institucionet e Kosovës. Një folës ka thënë se më shumë komunikim dhe bashkëpunim është i nevojshëm mes Prishtinës dhe institucioneve lokale në veri. Ai ka thënë se të dyja komunitetet do të duhej të fillonin “rrënimin e mureve”.

Përfundim

Edhe pse institucionet e reja të Kosovës nuk janë formuar edhe katër muaj pas zgjedhjeve, dhe përfaqësuesit e rinj serbë nuk e kanë pasur ende mundësinë të angazhohen në politika qendrore, shumica e folësve kanë thënë se ata duhet të vendosin një bashkëpunim të mirë me kolegët e tyre shqiptarë, dhe ka sygjerruar që ata sa më shpejtë të fillojnë të adresojnë çështjet e edukimit, shëndetësisë, dhe privatizimit në komunat me shumicë serbe. Asnjë nga këto çështje nuk mund të zgjidhet pa bashkëpunimin thelbësor me Prishtinën. Shumë pjesëmarrës shqiptarë dhe serbë besojnë se pjesëmarrja e të gjithë serbëve të Kosovës në jetën politike të Kosovës – si pjesë e institucioneve dhe duke votuar në zgjedhje – do të ndihmojë në zgjidhjen e çështjeve në nivelin lokal.

Mendimi më i përhapur ka qenë që edhe vetë komuniteti serb duhet të përfshihet më shumë dhe të përkrahë përfaqësuesit e tij me ide dhe këshilla. Shumica kanë thënë se do të nevojitet kohë që të transformohet marrëdhënia e tanishme konfliktuoze serbo-shqiptare, në një marrëdhënie partneriteti, posaçërisht kur shumë “elita politike të të dyja komuniteteve janë të korruptuara”, mirëpo, kushtet për një partneritet të tillë janë duke u përmirësuar gradualisht.

Anëtarët e Listës Srpska kanë shprehur publikisht pakënaqësinë e tyre me përfshirjen potenciale të Lëvizjes Vetëvendosje në një koalicion të ardhshëm qeveritar, “duke marrë parasysh retorikën nacionaliste të Vetëvendosje”. Por, disa diskutues kanë thënë se nëse Lista Srpska mund të punojë me Hashim Thaçin, i cili është i dënuar me 20 vite burg në Serbi për krime kundër serbëve, dhe me Ramush Haradinajn, i cili poashtu është i akuzuar nga Beogradi për krime lufte kundër serbëve, atëherë ajo do të mund të punonte me njerëz të cilët mund të kenë retorikë më nacionaliste. Përkundër kundërshtimeve të Srpska-s, shumë folës presin që Srpska t’i bashkohet koalicionit qeverisës të Kosovës, pavarësisht partive politike që ai mund të përfshijë.

Pjesëmarrësit

Renditja sipas alfabetit të gjuhës angleze

Illir Deda, Anëtar i parlamentit, Lëvizja Vetëvendosje
Sadri Ferati, Anëtar i parlamentit, Lidhja Demokratike e Kosovës
Shpetim Gashi, Nënpresident, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Ardian Gjini, Zëvendëskryesues, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
Alex Grigorev, President, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Marko Jaksic, Avokat, Mitrovicë
Selatin Kllokoti, Zyrtar i Programit, Instituti Demokraci për Zhvillim
Dragisa Krstovic, Këshilltar Politik, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të Kosovës
Arber Kuci, Bashkëpunëtor, Këshilli për Qeverisje Inkluzive
Leon Malazogu, Drejtor Ekzekutiv, Instituti Demokraci për Zhvillim
Krystyna Marty, Ambasadore e Zvicrës në Kosovë
Ljubisa Mijacic, Analist, Zubin Potok
Dardan Molliqaj, Sekretar, Lëvizja Vetëvendosje
Dragan Nikolic, Kryetari i Komunës së Parteshit
Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në Kosovë
Nenad Radosavljevic, Drejtor i bordit, Rrjeti i TV stacioneve serbe në Kosovë
Darko Radovanovic, Kryesues, Asambleja Komunale e Zvecanit
Naim Rashiti, Analist i lartë, Grupi i Ballkanit për Hulumtim të Politikave
Saskia Salzmann, Këshilltare e Sigurisë Njerëzore, Ambasada e Zvicrës në Kosovë
Besa Shahini, Analiste e lartë, Iniciativa Evropiane për Stabilitet
Rada Trajkovic, Ish-anëtar i parlamentit të Kosovës, Lista e Bashkuar Serbe
Talia Wohl, Zyrtar i Programit, Departamenti Federal i Punëve të Jashtme të Zvicrës